

VESHJET DHE STOLITË SI MBARTËSE TË EROTIZMIT NË KËNGËT POPULLORE TË JUGUT

Dr. DRITA ISUFAJ

Universiteti "Aleksandër Moisiu"

dritaisufaj@yahoo.com

ABSTRACT

Clothing in poetry and art is not just a means to cover or keep a person warm. In many moments, clothing loses its functionality and becomes a communicative value. In folk songs, the cases where clothes represent an erotic aspect are not uncommon. If we observe at Albanian traditional clothing, we see that men wore both clothing in the form of a wide skirt and those in the form of pants. Albanian men also wore various silver ornaments, such as chest pads, decorative swags on their vests, rings, pipes and cigarette boxes, but above all, the belt and arm weapons, which were always richly decorated. For women, the main types of clothing are: the jublet suit, the suit with a long shirt and jacket over it, the suit with two legs placed over the long shirt and the wrap suit. For brides, metal ornaments were inevitable, even used excessively. In this paper we will focus specifically on elements such as: the belt, the dress, the vest, the jamadan, the scarf, the lines, the ornaments as carriers of eroticism in the lyric's folk songs of south Albania.

Keywords: clothing, poetry, ornaments, woman, man, code, dress, belt

Veshja në poezi e në arte nuk është thjesht një mjet për t'u mbuluar a për të mbajtur ngrohtë njeriun. Në shumë raste ajo e humb funksionalitetin dhe bëhet një vlerë komunikuese. Në këtë punim ne do të ndalemi në mënyrë të veçantë në elemente si: brezi, fustani, jeleku, xhamadani, shamia, stolitë, si mbartës të erotizmit në vargjet të këngëve popullore të jugut.

Veshja është shprehëse dhe ka kodet e saj që shpesh flasin më qartë se fjalët; që nga lashtësia e deri më sot, ajo na flet me gjuhën e saj të jashtëzakon-shme.¹

Në veprën me titull “Psikologjia e veshjes”, gjashtë eseistë bashkëautorë përpiqen të japin një shpjegim të fenomenit në fjalë. Në esenë hyrëse, Umberto Eko, na tregon se në plot raste veshja e humb funksionalitetin dhe bëhet një vlerë komunikuese. Në një kohë kur studimi i semiologjisë dhe i kinestetikës çon në përfundimin se bota e komunikimit joverbal ka një shtrirje të pakufizuar, Eko pohon duke arsyetuar: “Nëse komunikimi shtrihet në të gjitha ato nivele, nuk është çudi se mund të ketë një shkencë të modës si komunikim dhe veshjes si një gjuhë e artikuluar”.²

Në krijimtarinë tonë folklorike janë jo të pakta rastet kur përmenden veshje të cilat përfaqësojnë një aspekt erotik. Le të shohim disa shembuj:

Faqet e kuqe lulet e dynjasë,
Ç’i kam bërë çupës që s’do të më flasë.
Pse s’më flet me gojë se më plase xhanë,
Xvarre nëpër këmbë se ç’m’a heq fustanë.
Vuaj moj kokë vuaj se të paçë thënë,
Ku e pate mëndjen sa qesh’i pa zënë.³

¹ Shënim: Veshje të spikatura në Bibël: Palltoja e Jozefit ishte një tunikë e gjatë, nga pëllëmbët e duarve deri te këmbët: "Dhe Izraeli e donte Jozefin më shumë se të gjithë bijtë e tij, sepse ai ishte një bir i pleqërisë. Dhe bëri një mantel deri në fund të këmbëve (Zanafilla 37: 3). Tunika e gjatë ishte profetike. Jozefi do të bëhej një ditë i dyti në krye të gjithë Egjiptit: "Dhe Faraoni hoqi unazën nga dora e tij dhe e la në duart e Jozefit; dhe e veshi me rrobat prej liri të hollë dhe i vuri në qafë një gjerdan të artë (Gjeneza 41:42). Veç kësaj, përmes rrethanave të pazakonta, djali i Jozefit, Efraimi do të caktohej i parëlinduri dhe do të bëhej kreu shpirtëror i familjes. Megjithatë, vëllezërit nuk shihnin përtej hundës së tyre: i ati po e vendoste vëllanë e tyre Jozefin mbi ta, pasi ky lloj i veshjes ishte i rezervuar për mbretërit, priftërinjtë dhe personat e rangut "... vëllezërit e tij panë që babai e donte më shumë se të gjithë vëllezërit e tij dhe nisën ta urrenin (Zanafilla 37: 4).

Gjithashtu, një tunikë e gjatë ishte veshja e vajzave të virgjra të mbretit, siç e shohim te Samueli 13: 18-19, pasi Tamara, vajza e mbretit, ishte përdhunuar nga gjysmë-vëllai i saj, Ammoni. "Dhe një tunikë e gjatë ishte mbi të, sepse kështu visheshin zakonisht vajzat e virgjëra të mbretit. Tamara mbajti mbi kokë hirin, grisi tunikën e saj, vuri dorën mbi kokë dhe u largua duke bërë titur. Ajo e grisi tunikën e saj, sepse Ammoni ia mori virgjërinë, duke ia shkelur të drejtën për ta veshur atë. Tunika e gjatë e vajzës së virgjër duhej të ishte prej liri të bardhë, pasi ky i fundit ishte simbol i pastërtisë.

² Eco U., Dorfles G., Alberoni., Livolsi M., Lomazzi G., Sigurta R. (1975), *Psicología del vestir*, Editorial Lumen, Barcelona, f. 538

³ Palaj B. & Kurti D. (2007), *Visaret e kombit IV*, Botime françeskane, Shkodër, f. 250

Se ç’m’a le xhadenë se ç’më more rrugën,
Mortja më të hëngërtë sa m’a dashke burrën!

...

Fustanë e kuq ç’m’a mbanje mbi gjunjë,
sa m’a dashke burrën!
Qameti u bëftë n’u-ndafsh ti na unë.
sa m’a dashke burrën! ⁴

Të tjera vargje, krahas këtyre më sipër do të na flasin për kapelën,
brezin, stolitë etj:

Me gjith këto fjalë,
Ti s’më kuptove,
Vetullat m’i vrenjte,
Me sy s’më vështrove.

Me kapello tënde,
Mëndjenë ma morre.

Dy, tri herë ditën,
M’i ndëron fustanët.
Malli më ka marrë
Të të puth në ballët. ⁵

Në krijimtarinë popullore paraqitja e veshjeve është nga më
mbresëlënëset:

Me ngadalë vallenë,
Moj syzezë,
Se na ngrihet pulhuri
Moj syzezë,
Pluhuros fustanenë,
Moj syzezë,
Ay beu që më ka,
Moj syzezë,
Më ka rënë me sevda

⁴ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit IV, Botime françeskane, Shkodër, f. 265

⁵ Instituti i kulturës popullore. (1981), Lirika popullore 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f. 234

Moj syzezë,
 Kur më mori ashtu më tha
 Moj syzezë,
 Grisi pa të blej të ra
 Moj syzezë. ⁶
 Kur më shkonje në divan
 Fustanë m'a hiqje bram;
 Tundej oda me tavan ⁷,

Me fustan të bardhë,
 Herë më të zi,
 Të keqen moj Viktori. ⁸

Nëse ndalemi te veshjet popullore shqiptare shohim se burrat kanë mbajtur si veshjet në formën e një fundi të gjerë, ashtu edhe ato në formë pantallonash, por të parat kanë dalë nga përdorimi më herët se të tjerat. Pjesët më të zbukuruara ishin jelekët dhe xhamadanët e kostumit festiv. Burrat shqiptarë mbanin edhe stoli të ndryshme argjendi, si jastekë gjoksi, sumbulla dekorative tek jelekët, unaza, çibukë e kuti cigaresh, por mbi të gjitha qëndrojnë, armët e brezit e të krahut, që ishin gjithnjë të stolisura plot larmi.

Për gra, tipet kryesore të veshjeve, janë: kostumi me xhubletë, kostumi më këmishë të gjatë e xhokë shajaku sipër, kostumi me dy futa të vendosura mbi këmishën e gjatë, njëra përpara e tjetra prapa si edhe kostumi me mbështjellëse (një fund i hapur, i mbledhur tek beli me rrudha ose pala).

Në veshje, ngjyrat e zbukurimet ndryshonin simbas moshës. Për të vegjëlit e të rinjtë, kostumi krahinor mund të ishte më i thjeshtë. Ndryshe nga popuj të tjerë të Ballkanit, në Shqipëri, vajza që kishte arritur moshën e martesës, duhet të vishej thjeshtë e pa stoli, flokët t'i mbulonte mirë me një shami. Te nusët, stolitë metalike nuk mund të mungonin, madje, përdoreshin edhe me tepri, sepse në këtë rast, me sa duket, kishte rëndësi jo vetëm funksioni i tyre estetik, por edhe funksioni magjik që u përvishej. Për nusët, rëndësi të veçantë kishte

⁶ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit V, Botime françeskane, Shkodër, f. 173

⁷ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit V, Botime françeskane, Shkodër, f. 186

⁸ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit V, Botime françeskane, Shkodër, f. 191

edhe zbukurimi i kokës. Disa vjet pas martese, veshja e grave fillonte të lehtësohej nga zbukurimet.

Tani do të ndalemi në mënyrë të veçantë në elementët si: **brezi, fustani, jeleku, xhamadani, shamia, stolitë** në vargjet e këngëve popullore.

Brezi - Në një pjesë të mirë të këngëve popullore përmendet brezi apo qemer. Më poshtë po sjellim tekstin e një kënge çame të kurbetit ku “qemer” shfaqet si pjesë e rëndësishme e veshjeve festive:

Syzezë vetullzezë,
ke vjet që s’ke veshur brezë?
-Si ta vesh unë qemerë,
kur yt bir veron ngaherë,
po i mbushen dhjetë vjet,
pa qemer un’ s’kam lezet!
-Hesht nuse, hesht moj bijë,
do t’i shkruajmë të na vijë;
t’i bjem telit anembanë,
të na vinjë këtë javë.
Vish ti nuse piperinë,⁹
vish ti nuse gjithë stolinë,
çvish qemerë, vish fustanë,
të qëndisur me gajtanë,
ver’ të kuqe e ver’ të bardhë,
Bejcia vjen sonte dë Dardhë.¹⁰

Brezi tek femrat e mbledh mesin dhe thekson format e trupit. Në Bibël, në veprat mbi Romën dhe Greqinë e lashtë përmendet brezi. Imagjinohej se energjia seksuale vinte nga ijët, nga mesi, brezi shërbente për të mbuluar mesin.

Brezi i vajzave ishte simbol i virgjërisë dhe nëse një vajzë i dhuronte brezin një djali atëherë ajo po i falte atij dashurinë e saj. Në poezinë greke dhe romake heqja e brezit të një vajze tregon humbjen e virgjërisë së saj. Nëse udhëtojmë më tej, në Mesjetë, shohim se gratë që mbanin brez ishin të respektuara, ndërsa ato që shiheshin me sy jo

⁹ piperinë: fustan prej kadifeje, i gjatë deri në fund të këmbëve

¹⁰ Instituti i kulturës popullore. (1981), Lirika popullore 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f. 533

të mirë nuk mund ta mbanin atë. Burri rrëzonte brezin e gruas duke “rrëzuar” kështu alegorikisht ndarjen mes pjesës së pastër të trupit (të sipërme) dhe asaj të poshtme që pritej të bëhej “e papastër”. Një rast të tillë e hasim tek lirika jonë e njaohur “Njëzet e pesë gërsheta”, ku vajza i drejtohet djalit me fjalët:

O derr, o i bir' i derrit,
Më theve paftat e brezit!¹¹

Jelevu - Ashtu siç mbledh brezi mesin, jelevu mbledh pjesën e sipërme të trupit duke i bërë gjinjtë ngjashnjës. Veç ngjashnjimit të bukur ai mban plot fshehtësira që lidhen me të e që vlejné të hulumtohen në vijimësi. Në dy vargje të një lirike thuhet:

Moj e holla si fisheku,
mollatë s't'i nxë jelevu¹²

Shamia - Në këngët popullore shqiptare shamia e kokës përmenden shpesh:

Vasha me shami të hollë,
Me një elbeze në dorë;
Dolla një ditë në grurë,
Seç dëgjova tevaturre.
Bejka me këmborë gjyrrë,
S'm'a kish parë syri kurrë;¹³

Shamia mund të përfaqësojë pastërti, hijeshi dhe virtyt, ashtu sikurse edhe dëshirë seksuale dhe mund të jetë shenjë për sjellje jo fort të përmbajtura dashurore, për kapërcime e tejkalime.

Fustani - Ndër shekuj është përdorur si një metonimi e hollë e seksualitetit dhe si simbol i sharmit femëror e sensualitetit:

Ti moj çupëza beqare,
Kur më shkonje, n'ato varre
Me fustanin zvarrë-zvarrë
Të vdekurit seç i ngjalle,

¹¹ Mitko Th. (1981), Bleta shqiptare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f. 250

¹² Mitko Th. (1981), Bleta shqiptare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f. 140

¹³ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit III, Botime françeskane, Shkodër, f. 279

Të gjallët i vdiqe fare! ¹⁴
Thotë një këngë e njohur e jugut.

Në këngën e mëposhtme, personazhi që shfaqet me emrin e përveçëm *Rabushe* pret t’i vijë bashkëshorti nga kurbeti. Ajo për këtë rast është veshur me petkat më të bukura:

Sihariq Rabushe
se po të vjen burri,
merri shtamnat merri,
çap i mbush nga lumi,
sa lezet të ka bollka e fustani,
sihariq Rabushe
se të vjen jarani,
Rabushia me kalën
po vrapon pas fushës,
një shami të kuqe
rrethuar pas gushës,
Rabushja më kalë
po gjezdis pas malit
me një yll të math
mu në mes të ballit.

Tek Visaret e Kombit në një këngë kurbeti gjejmë këto vargje për “fustanin e burrit”:

Lanj fustanthin e t’im-zoti,
Sod më erth, nesër më ikën,
Përandaj po lanj e qanj. ¹⁵

Ndërsa më poshtë fustani me gjasë shënon mospërmbajtjen:

Oshtima jote
Kur del nga divani,
Po si dallg’e detit
Të hidhet fustani. ¹⁶

¹⁴ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit III, Botime françeskane, Shkodër, f. 281

¹⁵ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit IV, Botime françeskane, Shkodër, f. 265

¹⁶ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit V, Botime françeskane, Shkodër, f. 116

Ngjyrat e fustanit mbartin simbolika të ndryshme; në rastin e mëposhtëm vërejmë përdorimin e ngjyrës së zezë në funksion të krijimit të kontrastit me bardhësinë trupore, e cila me sa duket në këtë këngë duhet nxjerrë edhe më në pah se vetë fustani:

Fustan zi e pallë larë.
As më sheh as më kish parë,
Ngjal' e detit gushë bardhë ¹⁷

Stolitë

Ndër shekuj stolitë janë përdorur për të përcjellë fuqinë, madhështinë dhe bukurinë e dikujt. Shkëlqimi i gurëve dhe i metaleve të tyre të çmuara, larmia e formave, ndër të tjera shprehin luksin dhe dëshirën për t'u çliruar nga gjithçka që është e shëmtuar e negative.

Të mbajturit e një stolie në lëkurë të zhveshur mund të jetë një gjest intimiteti në vetvete:

Dy, tri berzelike
Ia ke vënë dorës,
Manushaq' e Prillit,
Në mes të të dëborës. ¹⁸

Në këngën e mëposhtme djali kërkon të përdorë si stoli për pushkën e tij, flokët e vajzës.

Ti moj çupëza kolopuçe,
As m'i jep ato cullufe
T'ia vë martines xhufkë!
As më jep një fill gërshetë
Ta bëj rripa për fishekë. ¹⁹

Pra si stoli mund të shërbejnë edhe sende që në vetvete nuk kanë vlerë materiale, por mbartin vlera shpirtërore dhe karakteristika personale.

Historia e stolive njeh shembuj të shumtë të të gjitha llojeve të kuptimeve. Të vendosura në pjesë të ndryshme të trupit, fytyrës,

¹⁷ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit III, Botime françeskane, Shkodër, f. 279

¹⁸ Palaj B. & Kurti D. (2007), Visaret e kombit V, Botime françeskane, Shkodër, f. 133

¹⁹ Dine S. (1962), *Valët e detit*, në: "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar", v. III, f. 44

gjoksit, duarve, krahëve, ato tërheqin vëmendjen duke shkaktuar edhe tërheqje erotike.

Përfundime

Në krijimtarinë popullore janë jo të pakta rastet kur përmenden veshje të cilat paraqesin një aspekt erotik. Pjesët më të zbukuruara ishin jelekët dhe xhamadanët e kostumit festiv. Burrat shqiptarë mbanin edhe stoli të ndryshme argjendi, si jastëkë gjoksi, sumbulla dekorative tek jelekët, unaza, cigarishte e kuti cigaresh, por mbi të gjitha, armët e brezit e të krahut, që ishin gjithnjë të stolisura në mënyrë të larmishme. Për gra, llojet kryesore të veshjeve, ishin: kostumi me xhubletë, kostumi me këmishë të gjatë e xhokë shajaku sipër, kostumi me dy futa të vendosura mbi këmishën e gjatë dhe kostumi me mbështjellëse. Për nuset, stolitë metalike ishin të pashmangshme, madje, përdoreshin edhe me tepri, sepse këtu, me sa duket, kishte rëndësi jo vetëm funksioni i tyre estetik, por edhe funksioni magjik që u përvishej. Rëndësi të veçantë kishte zbukurimi i kokës.

BIBLIOGRAFI

- Dine S. (1962), *Valët e detit*, në: “Mbledhës të hërshëm të folklorit shqiptar”, v. III
- Eco U., Dorfles G., Alberoni., Livolsi M., Lomazzi G., Sigurta R. (1975), *Psicología del vestir*, Editorial Lumen, Barcelona
- Instituti i kulturës popullore. (1981), *Lirika popullore 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
- Mitko Th. (1981), *Bleta shqiptare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
- Palaj B. & Kurti D. (2007), *Visaret e kombit III*, Botime françeskane, Shkodër
- Palaj B. & Kurti D. (2007), *Visaret e kombit IV*, Botime françeskane, Shkodër
- Palaj B. & Kurti D. (2007), *Visaret e kombit V*, Botime françeskane, Shkodër
- https://albkristian.com/bibla_shqip/b27c007.htm